



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KOMUNA PEJË

Nr. Protokollit:

Data: 30.06.2026



Në bazë të nenit 68, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), nenit 61 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Nr. 05/L-063, nenit 11 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna, neneve 6, 15 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenit 70 të Statutit të Komunës së Pejës, **Kryetari i Komunës së Pejës**, në bashkëpunim me **Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim Publik**, organizon:

DËGJIME PUBLIKE

për

Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027

Ftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Pejës, përfaqësuesit e bashkësive lokale, organizatat e shoqërisë civile, komuniteti i biznesit, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara, si dhe të gjithë akterët e tjerë të interesuar, të marrin pjesë në dëgjimet publike për **Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027**.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve publike është prezantimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Pejës për vitin 2027 dhe ofrimi i mundësisë që qytetarët të paraqesin propozimet, komentet dhe rekomandimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit të buxhetit.

Dëgjimet publike do të zhvillohen sipas **Kalendarit të Dëgjimeve Publike**, i cili do të publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Pejës dhe në kanalet zyrtare të komunikimit me publikun.

Projekt-Buxheti i Komunës së Pejës për vitin 2027, së bashku me dokumentacionin përcjellës, do të publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Pejës para fillimit të procesit të dëgjimeve publike.

Komentet dhe propozimet mund të dorëzohen edhe në mënyrë elektronike në adresat e mëposhtme: gazmend.turku@rks-gov.net, dielleza.berisha@rks-gov.net, hajrije.haxhijai@rks-gov.net, fatmir.mami@rks-gov.net, arianit.demaj@rks-gov.net.

KOMUNA E PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433

Kalendari i konsultimeve publike për Projekt-Buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2027

Nr	Vendi i mbajtjes	Banorët / Grupet e interesit	Data	Ora
1	Asamble Komunale	OJQ-të, organizatat e shoqërisë civile dhe klubet sportive	03/08/2026	12:00
2	Asamble Komunale	Qyteti - të gjitha bashkësitë lokale	03/08/2026	16:00
3	Asamble Komunale	Fshatrat e Rugovës	03/08/2026	18:00
4	Shkolla fillore në Nabërgjan	Trestenik, Nabërgjan, Treboviq, Ruhot, Lutogllavë, Llabjan, Bllagajë dhe Nakull.	04/08/2026	16:30
5	Qendra Rinore në Vitomericë	Vitomericë, Katundi i Ri, Brestovik, Lipë, Dubovë dhe Ozdrim.	04/08/2026	18:00
6	Shkolla fillore në Novosellë	Fshatrat e Podgurit	05/08/2026	17:30
7	Qendra Rinore në Gorazhdec	Fshati Gorazhdec	05/08/2026	19:00
8	Asamble Komunale	Gra, vajza, klubet sportive të vajzave, organizatat e grave dhe organizatat që veprojnë në fushën e barazisë gjinore.	06/08/2026	16:00
9	Shkolla fillore në Raushiq	Dobërdol, Llozhan, Graboc, Poçestë, Millovanc, Pishtan, Loxhë, Zllapek, Raushiq dhe Lubeniq.	06/08/2026	17:30
10	Shkolla fillore në Baran	Fshatrat e Lugut të Baranit	07/08/2026	17:30
11	Shkolla fillore në Qyshk	Fshatrat e Lugut të Leshanit	07/08/2026	19:00

KRYETARI I KOMUNËS

z. Gazmend Muhaxheri



KOMUNA E PEJËS
Adresa: Rr. Hasan Prishtina
Tel: 03820043433